

## FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

# Sikalastic®-835 I

MEMBRANË E LËNGSHME ME 2 PËRBËRËS PREJ POLIUREJE TË PASTËR DHE ME REZISTENCË TË LARTË KIMIKE DHE MEKANIKE

### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikalastic®-835 I është membranë e lengshme poliureje me 2 përbërës, elastike, 100% trupash të ngurtë dhe me tharje shumë të shpejtë. Sikalastic®-835 I mund të aplikohet vetëm me spërkatje me anë të pajisjes prej dy pjesësh për spërkatje me metodën e nxehtë.

### PËRDORIMET

Për zgjidhje hidroizolimi të tarracave në projekte restaurimi dhe ndërtimesh të reja:

- Membrana bituminoze ekzistuese
- Tarraca
- Roof screeds

Veshje për mbrojtje betoni sipas kërkesave të EN 1504-2, për:

- Ura
- Tunele

Struktura ujëmbajtëse metalike dhe prej betoni:

- Diga
- Kanale
- Rezervuare
- Rezervuarë sigurie për bimët petrokimike
- Tubacione

Hidroizolim mbi tarraca të përshtatshme për akses automjetesh dhe hapësira parkimi automjetesh.

Veshje për struktura skenike dhe dekorative.

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Kohë shumë e shpejtë tharjeje
- Lehtësi në aplikim mbi detaje, edhe kur aksesueshmëria është e kufizuar
- Elasticitet i lartë (>250%)
- Vetë të mira për ngushtim plasaritjesh (Kategoria A4 në +23°C / B3.1 në -20°C EN1062-7)
- Rezistencë e lartë ndaj përplasjeve, abrazionit dhe shpimeve
- Rezistencë e mirë ndaj shumë kimikateve
- I aplikueshëm në temperatura nga -15°C deri +70°C
- Performon në temperatura konstante të thata nga -30°C deri +140°C
- Përbërje e plotë trupash solidë, pa VOC
- Mbrojtje e shkëlqyer kundër korrodimit
- E përshtatshme për shumicën e nënshtresave (beton, metal, membrana bituminoze, mure dhe dru)

### MIRATIME / STANDARDE

- Mbart markën CE, sipas EN1504-2.
- Reagimi në zjarr (EN13823): Kategoria E
- Testi i ndikimit të përsheptuar nga kushtet e motit me UV (ASTM G 53)
- Koeficienti i rrëshqitjes (B.C.R.A. Method - D.M. 14/06/1989 No.236 Art: 8.2.2)

## INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Poliure aromatike me 2 përbërës		
Ambalazhi	Përbërësi A (rrëshira)	fuçi e zeze 205 kg	
	Përbërësi B (izocianati)	fuçi e kuqe 225 kg	
Ngjyra	Lëng / RAL6010 (e gjelbër), RAL6020 (e gjelbër), RAL 3009 (e kuqe), RAL 7040 (gri), RAL 9005 (e zeze). Ngjyra të tjera me porosi.		
Jetëgjatësia	Përbërësi A (rrëshira)	12 muaj nga data e prodhimit	
	Përbërësi B (izocianati)	12 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin original, të pahapur, të padëmtuar dhe të vulosur, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Temperaturat më të larta të magazinimit mund të reduktojnë jetëgjatësinë e produktit.		
Dendësia	Përbërësi A	~ 1.05 kg/l	(EN ISO 2811-1)
	Përbërësi B	~ 1.12 kg/l	
Vlerat e dendësisë janë përcaktuar në +25°C			
Përmbajtja e substancave të ngurta	100%		
Viskoziteti	Përbërësi A	300 - 500 mPas	(EN ISO 3219)
	Përbërësi B	500 - 800 mPas	
Vlerat e viskozitetit janë përcaktuar në +25°C			

## TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore D	~ 48	(EN ISO 868)
Rezistenca ndaj abrazionit	~ 20 mg	(EN ISO 5470-1)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~ 12 MPa	(UNI EN 12311-2 Part B)
Zgjatimi deri në thyerje	250 - 300%	(UNI EN 12311-2 Part B)
Rezistenca ndaj grisjes	~ 90 kN/m	(UNI EN 12310-2)
Aftësia e ngushtimit të plasaritjeve	Statike	> 1250 µm, kategoria A4 (+23°C)
	Dinamike	Kategoria B3.1 (-20°C) (EN 1062-7:2005)
Përshkueshmëria e avujve të ujit	~ 0.025	(ASTM E96)
Rezistenca kimike	Sikalastic®-835 I ka rezistencë ndaj shumë kimikateve (Metoda e testimit ASTM D1308 në +25°C). Ka gjithashtu rezistencë ndaj kontaktit afatgjatë me hidrokarburet (diesel dhe benzinë) për të paktën 72 orë.	

### Testimet e përshkueshmërisë së gazit:

Gazi	Kohëzgjatja / Presioni	Rezultati	(UNI EN 1779 / UNI EN 1330-8)
Helium	40 ditë: 15'd / 1,2 bar	pa rrjedhje	
Metan	40 ditë: 15'd / 1,2 bar	pa rrjedhje	
Radon	40 ditë / ambient	9 Bq/m <sup>3</sup>	

Ju lutemi kontaktoni me shërbimin teknik për më shumë informacione të detajuara.

Ekspozimi i njëkohshëm në sforcim termik dhe mekanik mund të reduktojë rezistencën kimike të produktit.

Fleta e të dhënave të produktit

Sikalastic®-835 I

Shkurt 2020, Botimi 03.01

02091560100000002

**BUILDING TRUST**



## Vjetrimi artificial

Sikalastic®-835 I është testuar sipas ASTM G53 (UVB-313 lamp / cikle 4 orëshe / +50°C U.R. 100%).

Vetia	Njësia e matjes	Ref.	Pas 1700 orësh	Pas 3200 orësh
E-modulus në 100%	MPa	6.5	7	7.16
E-modulus në 300%	MPa	10	10.33	10.78
Rezistenca ndaj tërheqjes	MPa	12	13.18	14.34
Zgjatimi deri në thyerje	%	250	266	255
Rezistenca ndaj grisjes	kN/m	90	93.44	107.98

Temperatura e funksionimit -30°C min. / +140°C max.

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

### Struktura e sistemit

Sistemi i veshjes	Produkti	Konsumimi
Sistemi për struktura betoni	1-2 x Sika® Primer Roof PU ose Sika® Primer Roof EP i spërkatur lehtë me rërë kuarci, 0.4-0.7 mm ose Sika® Concrete Primer	0.3-0.5 kg/m <sup>2</sup> /shtresë ~ 1.0 kg/m <sup>2</sup> ~ 1.08 kg/m <sup>2</sup> /mm
Sistemi për strukturat prej çeliku karboni	1 x Sikalastic®-835 I 1 x Sikalastic® Metal Primer i spërkatur lehtë me rërë kuarci, 0.4-0.7 mm 1 x Sikalastic®-835 I	0.35 kg/m <sup>2</sup> /shtresë ~ 1.0 kg/m <sup>2</sup> ~ 1.08 kg/m <sup>2</sup> /mm

Këto vlera janë teorike dhe nuk përllogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit të sipërfaqes, profilin të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel dhe firon, etj.

Gjatë fazës së projektimit, trashësia e Sikalastic®-835 I duhet të vlerësohet duke patur parasysh: qëllimin e përdorimit, nivelin e sforcimeve dhe qëndrueshmërinë e pritur.

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit -15°C min. / +70°C max.

Lagështia relative e ajrit 85% U.R. max.

Temperatura e nënshtresës -15°C min. / +70°C max.

### Pika e vesës

Kujdes kondensimin!  
Temperatura e nënshtresës duhet të jetë të paktën 3°C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit mbi sipërfaqe.

### Lagështia e përmbajtjeve të nënshtresës

< 4% pjesë për peshë përmbajtje lagështie.  
Metoda e testimit: matësi Sika®-Tramex, matja CM ose metoda e tharjes në furrë.  
Pa lagështi në ngjitje sipas ASTM 4263 (fletë polietileni).  
Për nënshtresa me përmbajtje të lartë lagështie aplikoni Sikafloor EpoCem® si një sistem barriere të përkohshme kundër lagështisë (TMB).

Fleta e të dhënave të produktit

Sikalastic®-835 I

Shkurt 2020, Botimi 03.01

020915601000000002

BUILDING TRUST



## Koha e pritjes / mbiveshja

Përpara aplikimit të Sikalastic®-835 I mbi Sika® Primer Roof PU ose Sika® Concrete Primer, lini:

Temperatura e nënshtresës	Min.	Max.
+10°C	2 orë	4 orë
+23°C	1 orë	4 orë
+30°C	1 orë	4 orë

Përpara aplikimit të Sikalastic®-835 I mbi prajmerat epoksidë me spërkatje të lehtë (Sika® Primer Roof EP), lini:

Temperatura e nënshtresës	Min.	Max.
+10°C	24 orë	36 orë
+23°C	12 orë	36 orë
+30°C	8 orë	36 orë

Përpara aplikimit të Sikalastic®-835 I mbi Sikalastic®-835 I lini:

Temperatura e nënshtresës	Min.	Max.
+10°C	10 sek.	7 orë
+23°C	10 sek.	6 orë
+30°C	10 sek.	5 orë

Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e sipërfaqes dhe kushtet e ndryshueshme të ambientit.

## Produkti i aplikuar gati për përdorim

Koha e krijimit të xhelit	Qarkullim këmbësorësh	Qarkullim i lehtë	Koha e tharjes
~ 5 sek.	~ 15 min.	~ 8 orë	~ 24 orë

Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

## UDHËZIME APLIKIMI

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

#### Cilësia e nënshtresës

- Nënshtresa prej betoni duhet të jetë e qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme ndaj ngjeshjes (min. 25 N/mm<sup>2</sup>) dhe me rezistencë min. ndaj tërheqjes 1.5 N/mm<sup>2</sup>.
- Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa kontaminues si papastërtitë, vaji, grasoja dhe trajtimet e sipërfaqes, etj.
- Në rast dyshimi, aplikoni më parë mbi një zonë për provë.
- Membranat bituminoze duhet të jenë të pastra, të paprekura, të vazhdueshme, me ngjitje të plotë mbi nënshtresë, me përmasa të qëndrueshme.

Metodat e përgatitjes së nënshtresës varen rreptësisht nga lloji i nënshtresës, kushtet dhe niveli i prituri i sforcimeve.

Nënshtresat të cilat duhet të lyhen gjithmonë me prajmer janë:

- nënshtresat me bazë çimentoje (beton, llaçe, suva, etj.) dhe tulla
- pllakat
- metalet

#### Përgatitja e nënshtresës

Metoda e përgatitjes së nënshtresës varet rreptësisht nga materiali i nënshtresës, gjendja e tij dhe veçanërisht në nivelin e prituri të sforcimeve.

Nënshtresat e mëposhtme duhet gjithmonë të lyhen

me prajmer:

- Nënshtresa me bazë çimentoje (beton, llaçe dhe suvatime) dhe tulla
- Pllaka
- Nënshtresa metalike

*Nënshtresa me bazë çimentoje, tulla dhe pllaka*

Nënshtresat me bazë çimentoje, tullat dhe pllakat duhet të përgatiten mekanikisht me pajisjen e duhur të fërkimit për të hequr koren e çimentos (qumështin), materialet e lira dhe të shkrifëta që të arrihet një sipërfaqe me teksturë të hapur.

Materiali i dobët duhet të hiqet dhe defektet si vrimat dhe hapësirat duhet të ekspozohen plotësisht.

Riparimet mbi nënshtresë, mbushja e vrimave/hapësirave dhe nivelimi i sipërfaqes duhet të kryhen duke përdorur produktet e duhura nga seria e materialeve Sikafloor®, SikaDur® ose Sika MonoTop®.

Sipërfaqja duhet të nivelohet që të arrihet një sipërfaqe e niveluar me pjesë të ngritura.

Pluhuri, materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet me vakuum përpara aplikimit të produktit.

Sipërfaqja duhet të lyhet me prajmerin Sika® Primer Roof PU. Në rast nënshtresash me absorbueshmëri të lartë të cilat duhet të konsolidohen, lyeni me prajmerin Sika® Primer Roof EP të spërkatur lehtë me rërë kuarci, 0.4-0.7 mm, përpara aplikimit të Sikalastic®-835 I.

Fleta e të dhënave të produktit

Sikalastic®-835 I

Shkurt 2020, Botimi 03.01

020915601000000002

BUILDING TRUST



### *Metal*

Sipërfaqet metalike duhet të përgatiten me pastrim me rrymë rëre deri në Sa 2 ½ (ISO 8501-1) ose SSPC-SP 10. Nënshtrësia nuk duhet të ketë ndotje që dëmtojnë ngjitjen, preferohet pastrim me ujë në presion të lartë përpara pastrimit me rrymë rëre. Sipërfaqja duhet të lyhet me Sikalastic® Metal Primer. Pastaj, aplikoni shiritin izolues Sikalastic® Flexistrip përgjatë fugave, plasaritjeve apo pikave (p.sh. fiksues/mbërthyes mekanikë).

### *Membranë bituminoze*

Plasaritjet ose dëmtimet e membranës duhet të riparohen me produktet e përshtatshme (p.sh. shkuma SikaBoom®, izolues poliuretani me modul të ulët SikaHyflex®-250 Facade, shiriti izolues i paraformuar Sikalastic® Flexistrip ose Tape rl 80 s). Në vijim sipërfaqja duhet të pastrohet plotësisht me rrymë uji në presion të lartë. Pas tharjes së sipërfaqes, mund të aplikohet prajmeri i kërkuar.

### **APLIKIMI**

Aplikoni duke përdorur një pajisje spërkatjeje me 2 pjesë, me nxehtësi dhe presion të lartë. Pajisja proporcionuese e përdorur duhet të ketë kapacitet furnizimi me presionin dhe nxehtësinë e saktë për gjatësinë e përshtatshme të tubit në një bazë të vazhdueshme.

Të dy përbërësit duhet të nxehen deri në +60 ÷ +80°C, në fuçi edhe në tub. Sistemi i riqarkullimit duhet të aktivizohet gjatë nxehtësisë paraprake të fuçive. Raporti i saktë i përzierjes është 1 : 1 për vëllim. Saktësia e përzierjes dhe dozimit duhet të kontrollohet rregullisht me pajisjen.

Përziëni plotësisht përbërësin A të Sikalastic®-835 I, rrëshirën e pigmentuar me një mikser në shpejtësi të ulët derisa të përftohet një përzierje dhe ngjyrë homogjene.

Për përbërësin B (izocianati), rekomandohet përdorimi i filtri të përshtatshëm për tharje në mënyrë që të mbrohet ky përbërës nga lagështia.

KUJDES: mbi nënshtrësia shumë absorbuese, që të shmangët krijimi i vrimave apo plasaritjeve mbi sipërfaqen e produktit (të sapospërkatur), rekomandohet aplikimi i prajmerave epoksidë si Sika® Primer Roof EP në shumë shtresa derisa të jetë mbuluar poroziteti. Spërkasni lehtë me rërë të pastër dhe të thatë kuarci, 0.4 - 0.7 mm. Mos spërkasni plotësisht prajmerin me rërë kuarci.

Aplikoni sistemet e përshtatshme për të izoluar fugat dinamike, lidhjet dhe plasaritjet. Ju lutemi kontaktoni me shërbimin teknik për më shumë informacione të detajuara.

## **KUFIZIME**

- Ky produkt duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.
- Për aplikimin me spërkatje është i detyrueshëm përdorimi i pajisjeve mbrojtëse për shëndetin & sigurinë! Lexoni skedën përkatëse të të dhënave të sigurisë për më shumë informacione të detajuara.
- Aplikimi kryhet duke përdorur pajisje spërkatjeje proporcionale me 2 pjesë, të nxehtë dhe në presion të lartë.
- Në ekspozim të drejtpërdrejtë rrezatimi UV Sikalastic®-835 I do të çngjyroset dhe mund të paraqesë disa tendenca kalcifikimi.
- Sikalastic®-835 I të mos aplikohet mbi FPO dhe PVC të plastifikuar.
- Mos aplikoni afër ventiluesve të hyrjes së ajrit të një njësie kondicionimi e cila është në punë e sipër.
- Materialet bituminoze volatile mund të njojnë veshjen. Përdorimi i prajmerave të duhur, shmang këtë fenomen.

## **BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT**

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## **KUFIZIME LOKALE**

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## **EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI**

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



### Fleta e të dhënave të produktit

Sikalastic®-835 I  
Shkurt 2020, Botimi 03.01  
020915601000000002

Sikalastic-835I-sq-AL-(02-2020)-3-1.pdf

